

QEMAL HAXHIHASANI

DISA TË DHËNA RRETH LËVIZJES DHE KËNGËVE
POPULLORE TË KAÇAKËVE NË SHQIPËRI

Lëvizja e kaçakëve¹ dhe krijimet artistike popullore përkatëse, si një fenomen tipik historiko-shoqëror dhe kulturalo-artistik i popujve të Evropës juglindore, ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e studjuesve. Studime me interes janë bërë sidomos në këto kohët e fundit, për të vënë në pah ekzistencën e këtij fenomeni në vendet e ndryshme të kësaj treve, premisat historike që kanë kushtëzuar gjenezën, karakterin dhe tendencat e zhvillimit të tij, afëritë tipologjike dhe ndikimet reciproke midis krijimeve popullore të këtyre vendeve. Me gjithë rezultatet e arritura, studimet në drejtim të zgjerimit të njohurive rreth ekzistencës dhe veçorive kombëtare të këtij fenomeni, si edhe në atë të problemeve të ndërlidhjes dhe të ndërveprimit me njëri-tjetrin, ngjallin interes dhe ruajnë gjithmonë vlerë aktuale.

Lëvizja e kaçakëve ka paraqitur një formë të përgjithshme të protestës kundër shtypjes së pushtuesit të huaj dhe kundër shfrytëzimit ekonomiko-shoqëror të klasave në fuqi. Në kushtet historike të zhvillimit të saj, në pamundësi të një organizimi dhe të një udhëheqjeje me një platformë politike të caktuar, ajo mbeti brenda caqeve të një lëvizjeje me karakter spontan dhe të një revolte individuale. Motivet e rebelimit dhe origjina shoqërore e kaçakëve, ndikimi i presionit të veprimtarisë luftarake të tyre kundër pushtetit shtetëror të pushtuesit dhe marrëdhënieve shoqërore ekzistuese, i japin kësaj lëvizjeje një vlerë të padiskutueshme.

Materialet shqiptare sjellin dëshmi të pasura rreth karakterit klasor të lëvizjes së kaçakëve, rreth krijimeve poetike popullore që lindën si jehonë e saj, rreth lidhjeve të kësaj lëvizjeje me momentet e rëndësishme të historisë sonë kombëtare etj.²

Ashtu si edhe në këngët kleftike të popujve të tjerë të Ballkanit, temat themelore të këngëve tona të kaçakëve, të cilat zënë një vend të rëndësishëm me përmbajtjen dhe veçoritë e tyre artistike në krijimet poetike popullore shqiptare, janë: a) lufta kundër shtypjes politike; rebelimi kundër ligjeve të administratës së pushtuesit dhe b) lufta kundër shfrytëzimit ekonomiko-shoqëror të klasave shfrytëzuese në fuqi.

Këngët popullore të arbëreshëve të Italisë, të cilët kanë qenë detyruar të emigronin nga Atdheu kryesisht në kushtet e luftrave anti-

1) *kaçak-u* sh. *kaçakët* = njeri i arratisur ilegal, i dalë kundër ligjeve të administratës shtetërore, (nga turq. *kaçmak* = arratisem).

2) Përveç materialeve të botuara, kërkimet folklorike të zhvilluara në vendin tonë gjatë periudhës së ndërtimit socialist (ekspeditat e viteve 1949, 1952-53, 1954-56, 1957 dhe ekspeditat e viteve 60) e kanë pasuruar fondin e Arkivit të Institutit të folklorit me një material të pasur rreth figurave të njohura dhe të reja të kësaj lëvizjeje.

turke të shekullit XV e XVI, sjellin figura luftëtarësh që jetojnë në arrati pas thyerjes së rezistencës shqiptare të kësaj periudhe.³ Edhe këngë të tjera që u përkasin kohërave të mëvonshme tregojnë se lëvizja e kaçakëve është ushqyer vazhdimisht nga luftëtarë, që nuk kanë pranuar të dorëzohen te armiku pas dështimit të kryengritjeve të mëdha popullore. Figura të tjera kaçakësh janë detyruar të marrin rrugën e arratisë nga padrejtësitë shoqërore të kohës, nga kundërshtimi i ligjeve financiare, të shërbimit ushtarak, nga grindjet me feudallët për arësye ekonomike e shoqërore të ndryshme (kundër arbitrarishtetit të zgjerimit të pronave të tyre, nënshtrimit moral etj.).⁴

Në shumicën e rasteve kaçakët vinë nga ambjenti i shtresave shoqërore të varfëra. Kjo origjinë shoqërore e tyre shprehet me qartësi ndonjëherë dhe në vetë vargjet popullore.⁵

Lëvizja e kaçakëve ka paraqitur një forcë opozitare të vazhdueshme, që e ka mbajtur gjithmonë në presion pushtuesin e huaj dhe klasat sunduese. Kjo kuptohet nga përmbajtja e këngëve që flasin për kaçakët, të cilët bllokojnë rrugët publike, sulmojnë karvanet e postës, financat, vetë qeveritarët e lartë të administratës shtetërore (këngët e Marka Kulit, Kolë Pashës, Bec Patanit, Zek Jakinit, Nexhip Gostivishtit, Lumën Balës etj.); ndalojnë mbledhjet e taksave në zonat e veprimit të tyre (kaçakët e Bruzjes-Krujë), pagesat e detyrimeve feudale (Brahim Gjoci-Zadrimë 1769); (marrin sklevër ose kërkojnë shpërblime [ksegora] ndër të pasur (Kapedan Naumi, Kapedan Spanoi) etj. Kjo kuptohet gjithashtu nga shqetësimet e pushtuesit, që mban në këmbë trupa speciale (koshadhat) ose mobilizon forca të shumta ushtarake për ndjekjen dhe asgjësimin e tyre.

Limeret e kaçakëve janë zakonisht në malet e vendeve të tyre, ndërsa sfera e veprimit në krahinat rreth e rrotull (Bilbilenjtë psh. në malet e Kurveleshit, kaçakët e Kolonjës në Gramoz, të Devollit në Moravë etj.). Por veprimtaria e tyre shtrihej shpeshherë edhe në zona të largëta, siç ndodhte psh. me kaçakët e Jugut: Bilbilenjtë, Sheme Gjirokastritin, Spiro Labovën, Andruc Murgaçin, Nikëlekaj etj., që futeshin deri në zona të thella të Greqisë e të Maqedonisë. Në të tilla raste ata bashkëpunonin me kaçakë vendas, me kleftë të njohur grekë a hajdutë maqedonas.⁶ Raste të tilla bashkëpunimi ka pasur edhe ana-

3) G. De Rada, *Rapsodie d'un poema albanese*, Firenze 1866 (kënga e Pjetër Shinit, f. 100, e Dedë Skurës, f. 66).

4) Në bazë të arratisjeve të kaçakëve tanë qëndron rregullisht një motiv i tillë. Kështu arratisja e njërit prej kaçakëve të njohur të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, Zejnel Gjolekës, lidhet me vrasjen e një kaftanasit në Manstir rreth vitit 1830; arratisja e Nexhip Gostivishtit me vrasjen e kajmekamit të Kolonjës; e kaçakëve të Devollit (Kalem e Kamber Rakickës) me vrasjen e një beu në Zëmlak (Abdulla bej Zëmlakut); e File Zikës me vrasjen e bejlerëve të Gramshit, e Lumën Balës me vrasjen e një kajmekami në Nartë dhe të një «tyxhari» në Vlorë etj. Disa prej tyre si Nure Bozhigradi, Mane Mema, Dyle Shqau etj. arratisen duke dalë nga burgjet, ku kanë qenë mbyllur gjithashtu, për motive të njëjta.

5) Shqetësimet të gruas së njërit prej kaçakëve të shekullit të kaluar, Shemo Gjirokastritit, për fatin e fëmijve pas vrasjes së tij *Sheme qysh do të rriten djemtë? kënga popullore* i përgjigjet me gojën e heroit: *Ashtu siç jam rritur vetë, / me rrepicë e me lëpjetë*.

6) Sipas një kënge popullore greke, në çetën e një kaçaku shqiptar, që mendohet të ketë jetuar në çerekun e parë të shekullit XVIII, ishin grumbulluar shqiptarë, bullgarë e vllahë: «Dollë Lazja në male dhe grumbullonte trima bullgarë e shqiptarë dhe çobej të zgjedhur me palla prej ërgjëndi...» II. 'Αραβαντι-ρολ. Συλλογή Δημιόδων ἀσμάτων τῆς Ἡπείρου. Ἀθήναι 1880, f. 29.

sjelltas me kleftë e hajdutë të vendeve të tjera në zonat shqiptare. Kështu kaçakë maqedonas kanë bashkëjetuar me kaçakë shqiptarë në malet e Korçës e të Pogradecit. Për ndonjerin prej tyre thuhet se ka jetuar edhe në zona më të brendshme (Kurvelesh). Bashkëpunim të veçantë ka pasur sidomos midis kaçakëve shqiptarë dhe atyre aromunë. Nexhip Gostivishti, që vret kajmekamin e Kolonjës nga mezi i shekullit të kaluar, kish në çetën e tij 3 vllahë (Kostën, Vasilin dhe Kiço Çobanin); Kapedan Bilka i Prishtës (Skrapar) ishte vëllam me vllahun Tamo; Ismail Dërdusha me një farë Dhimitri. Kështu edhe anasjelltas: në çetën e Mitru Vllahut bashkëjetonin kaçakë nga malësitë e rrethit të Tiranës.⁷

Në kushtet e një tradite bashkëpunimi të tillë, që përbën një element me interes në praktikën e bashkëpunimit spontan popullor të popujve të Ballkanit, lindën ndikime reciproke, qoftë në drejtim të veprimtarisë luftarake, formave organizative etj., qoftë në drejtim të krijimeve dhe huazimeve artistike popullore (lidhur me tematikën, motivet, mënyrën e ekzekutimit të këngëve dhe valleve etj.). Në këtë kuadër janë për t'u përmendur edhe këngët që lartësojnë figura dhe gjeste kaçakësh të kombësive të tjera siç janë psh. këngët shqiptare për kleftët grekë, ato për kapedanët aromunë (Kapedan Leonidhën etj.) ose anasjelltas, këngët greke që lartësojnë figura kaçakësh shqiptarë (Deli Huson, Tahir Jaçen, Lazen, Hasan Benjën, Lake Panaritin⁸ etj.). Në këngë të tilla ndjehet dashuria, admirimi dhe solidariteti me përpjekjet, që bëhen për aspirata të njëjta shoqërore, vlerësohen jashtë paragjykimëve kombëtare virtytet dhe vetitë morale që shfaqen në luftën kundër një armiku të përbashkët, për realizimin e qëllimeve të njëjta. Në një këngë greke p.sh. admirohet guximi i një kaçaku shqiptar. Deli Husos, që ka mundësi të ketë jetuar në vitet e para të shekullit XVIII: Deli Husua në mal doli kleft i parë mblidhte djem trima gjithë djem shqiptarë, i mblidhte, i grumbullonte, i bëri tri mijë. — Djema, në doni kaçakllëk, të ngrihen kleftë të më pyesni mua se si ecin kleftët: Vini çelik në zemër e hekur në këmbë...⁹ Në këngën shqiptare për Kapedan Leonidhën, vllah karagunas nga Strivadhët, lartësohet lufta e tij kundër qeveritarëve turq të Janinës.

Me interes janë të dhënat rreth organizimit të çetave të kaçakëve, disiplinës së brendshme, mënyrës së jetesës dhe veprimtarisë luftarake të tyre, autoritetit të kryetarit a kapedanit të çetës, legjendari-zimit të forcës së tij, ndikimit tek shokët etj.¹⁰

Një element që ndeshet në këngët e kleftëve të popujve të tjerë të Ballkanit dhe që shton romantikën e tyre është pjesëmarrja e gra-

7) C.N. Burileanu, *Dela Românië din Albania*, București 1906., f. 208.

8) Arkivi i Instituit të folklorit, Fondi minoritar, vëll. I, f. 127; Aravantinol, *rep. e cit.*, f. 27, 29, 30 etj. *Helenika dhimotika tragudhia* tom A', 1962, f. 206 e 208.; M. Vitti, *Canti dei ribelli greci*, Firenze 1956, f. 74.

9) Arkivi i Institutit të folklorit, Fondi minoritar.

10) Kaçakët shqiptarë jetonin zakonisht në grupe rreth 10 vetësh, por në raste të veçanta kjo shifër rritej sipas mundësive dhe nevojave luftarake të tyre. Çeta e Bibilenjve përbëhej nga 13 vetë, *Bibilenjtë trembëdhjetë*; çeta e Lul Çaparit shkonte deri në 40 (në limerin e tij, në malin Luarat, thuhet se kanë qenë të ngulura deri vonë në një trung rrapi 40 perona trarishte, ku vareshin armët e 40 trimave të tij); për çetën e Kajo Babjenit (Pogradec), thuhet se kish arritur në ndonjë rast deri në 300 vetë etj. Kryetari i çetës a kapedani jepte urdhërat

ve në çetat e «hajdutëve» a të kleftëve. Në këngët tona idealizimi i figurës së gruas si «kaçkinë» është fenomen i rrallë. Te kënga e «Halilit dhe e Musës» p.sh., vërtet flitet qartazi për nisjen e një jete të tillë: *Ç'bani e motra për Halilin? ... /Vrau tre vetë e duel kaçkinë,*¹¹ por ky fakt, me gjithë romantikën e tij, mbetet pa shtjellime. Edhe gërshetimi i martesave a i dashurive në të tilla këngë është i kufizuar (krs. këngën e Sh. Matrakut). E kundërta ndodh me rolin që lozin gratë në çastet dramatike të ndeshjes së heronjve me forcat e armikut. Në të tilla raste ato bëhen mbështetja kryesore për shpëtimin e heronjve, duke luftuar me trimëri e guxim krah për krah tyre dhe duke u ngritur kështu në një pjedestal lavdie, që flet në një mënyrë të fuqishme për madhësinë e tyre morale¹².

Në kushtet e anarkisë së administratës së pushtesit çetat e kaçakëve merrnin përsipër ruajtjen e këtij ose atij fshati, të kësaj ose asaj krahine, e cila nga ana e vet i ndihmonte me ushqime ose u vinte në ndihmë edhe me armë në raste rrethimesh dhe ndeshjesh me forcat qeveritare.

Në traditën popullore ruhen kujtime rreth solidarizimit të kaçakëve me vuajtjet e të varfërve dhe rreth inisiativave që merrnin për ndihmën e tyre ose për punime në dobi të përgjithshme.

Vlerësimi i përmbajtjes morale të figurës së kaçakut është bërë nga dy kënde të kundërta. Pushtuesi dhe klasat në fuqi janë përpjekur ta paraqesin atë si një vjedhës të thjeshtë dhe thyes të rendit shoqëror (në ndikimin e një qëndrimi të tillë lidhet edhe kuptimi përbuzës i termave *cub*, *hajdut*, *kaçak*); ndërsa populli, në figurën e kaçakut, ka parë përfaqësuesin tipik të aspiratave të tij për atë kohë, trimin, që lëftonte për dëshira të mëdha popullore, kundër padrejtësive që lindnin nga kontradiktat klasore të shtypjes dhe të shfrytëzimit me pushtuesin e huaj dhe klasat shfrytëzuese në fuqi, nga kontradiktat midis sunduesit dhe të sunduarit, të pasurve e të varfërve. Prandaj populli e ka rrethuar figurën e kaçakut me një dashuri dhe nderim të veçantë, ka çmuar në një shkallë të lartë vetitë morale e luftarake të tij;¹³ prandaj u ka dhënë edhe një kuptim pozitiv, sinonim me «trimin e veçantë», emrave *cub*, *hajdut*, *kaçak*, që përdor për ta.

Rebelimi i kaçakëve, rezistenca e armatosur dhe fitoret e tyre rritnin djenjat e revoltës kundër shtypjes dhe nënshtrimit, forconin ndër-gjegjen klasore. Të bëmet e tyre ndikonin edhe në lëvizjet kryengritëse masive, qoftë me gjendjen e acaruar dhe të tendosur që krijonte presioni i vazhdueshëm i tyre, qoftë me ushqimin e këtyre lëvizjeve me luftëtarë nga radhët e kaçakëve. Për t'u pasur parasysh, në mënyrë të veçantë, është fakti se në mjaft çaste të rëndësishme të historisë sonë kombëtare

dhe mbante marrëdhënje me stanarët, fshatrat etj. Njërin prej pjestarëve të çetës e bënte vëllam ase «bir me shpirt» (gr. psihojo). Vetëm ky kish të drejtë të mbante armët e kapëdanit a vulën e tij, t'i qëndronte gjithmonë pranë në udhë, në pusë e në luftime; t'i rrinte roje kur flinte etj.

11) Këngë popullore historike 1956, f. 113.

12) Krs. Këngët e B. Patanit, M. Dacit, Xh. Kampulës, C. e L. Likës, H. Kaçakut

13) Cubin në krahinat tona të Veriut e ulnin në krye të vendit se «ky, thonin ka qitë pushkë me gjeveri». Në këngët, që lartësojnë gjetet e kaçakëve, del qartë edhe krenaria popullore për ta: *Kush polli si polla unë? /Bëra djatë Sulo Hajdunë, /Sulo trimin faqekuajnë.*

figura kaçakësh, jo vetëm që u bashkuan, por edhe u vunë në krye të lëvizjeve të mëdha popullore.¹⁶ Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i këtij shekulli në lëvizjen e kaçakëve depërtuan edhe ide patriotike të Rilindjes. Nën ndikimin e çetave të çlirimit kombëtar kishte edhe raste kur geta kaçakësh, si ajo e Kajo Babjenit, hynë drejtpërsëdrejti në shërbim të lëvizjes çlirimtare kombëtare.

Siç është përmendur, pas këngëve arbëreshe që sjellin jehonën e luftimeve shqiptaro-turke të shekullit XV e XVI, këngët tona popullore historike të kaçakëve na shpjen në ngjarje që zhvillohen në vitet e para të shekullit XVIII¹⁷. Gjerësi paraqet kjo temë sidomos me figurat e kaçakëve, që kanë vepruar në periudha të caktuara të shekullit të kaluar, në kushtet e principatave shqiptare të Shkodrës dhe të Janinës (çereku i parë i shekullit XIX), të lëvizjeve popullore të viteve 30, të kryengritjeve fshatare të viteve 40 dhe në periudhën e Rilindjes. Lidhja që paraqet lëvizja jonë e kaçakëve në këto etapa të rëndësishme të historisë sonë e bën pa bazë mendimin e çfaqur rreth rolit që mund të ketë lozur në zhvillimin e këngës shqiptare «riorientimi politik dhe aktiviteti i Austrisë dhe i Venedikut në popujt e shtypur të Ballkanit¹⁸. Për kushtet e veçanta historike të vendit tonë lëvizja e kaçakëve, në komponenten e luftës kundër pushtuesit të huaj, vazhdoi deri në shpalljen e pavarësisë më 1912; ndërsa për popujt e tjerë të Ballkanit që kishin fituar pavarësinë e tyre shtetërore kohë më parë, ajo e kish humbur tashmë aktualitetin e saj.

Të lidhura me historinë dhe luftërat e popullit shqiptar, me ngjarjet konkrete të historisë së tij, këngët tona të kaçakëve ruajnë një karakter realist dhe një fizionomi të tyre kombëtare. Ashtu si edhe në këngët tona popullore historike në përgjithësi, këngët e kaçakëve pasqyrojnë përmbajtjen themelore të fakteve, shprehur nëpërmjet mendimit poetik. Ato fiksojnë momente të caktuara historike, sjellin jehonën e ngjarjeve reale, të gjesteve të personazheve me një identitet të qartë historik. Fiksimi i këtyre elementeve kërkon një gjuhë artistike të veçantë më reale, më origjinale dhe më kombëtare se sa ajo e balladave me subjekte të një karakteri ndërkombëtar a të epikës legjendare në përgjithësi. Pikërisht për këtë specifikë të saj kënga shqiptare, në përputhje me realitetin historik që trajton, ka përpunuar edhe mjetet e veta të ndërtimit dhe të formës së saj artistike. Kështu ajo nuk lejon motive, figura dhe elemente të një ambjenti fantastik përrallor, simbole që hasen në këngë të tilla të disa popujve të tjerë të Ballkanit. Në këngët shqiptare nuk gjejmë p.sh. kuaj të mrekullueshëm si në baladat «hajduçeske» rumune, personifikime të pyllit a dialogë me zogj fatidikë si në balladat bullgare, motive të ëndërrave a të tharjes së luleve që paralajmërojnë fatkeqësi a vdekjen e heroit, simbolin e martesës me vdekjen, të rritjes së pemëve mbi varrin e klefrit të vvarë etj.; nuk gjejmë skema të një

16) Kështu kryengritja fshatare e Leskovikut dhe e Kolonjës më 1831 u udhëhoq nga Zylyftar Poda, i cili kish jetuar në arrati që nga prishja e Ali Pashë Tepelenës më 1822. Një nga udhëheqësit e kryengritjes së njohur të Labërisë kundër Tanzimatit (1847), Zejnel Gjoleka, kish jetuar për një kohë të gjatë më parë si kaçak.

17) Një material i pasur rreth figurave luftarake të kësaj lëvizjeje gjendet nëpër dokumentat turke të kohës, në sixhilatin e Beratit etj. Kërkimi sistematik dhe evidencimi i këtyre të dhënave, së bashku me këngët dhe kujtimet gojore, mund të sillte një kontribut për historinë tonë kombëtare.

18) A. Schmaus, *Die albanische Volksepik*, «Shejzat» 1963, nr. 5-8, f. 175.

gjerësie të tillë fantastike p.sh. si ajo e lëvdimit të maleve të Olimbit dhe të Kisavos të baladës greke për ndihmën që u japin kleftëve.

Këngët tona të kaçakëve i karakterizon në radhë të parë mungesa e elementit të mrekullueshëm. Në to nuk janë të zakonshme gjithashtu format tradicionale të kompozimit epik; nuk hasen ato vija skematike të hyrjeve, të fillimit e zhvillimit të aksionit, përsëritjet, dialogjet, figurat etj., që janë në unitet të mendimit poetik dhe të formës artistike të këngës legjendare. Mungesa e këtyre elementeve, sidomos e elementit të mrekullueshëm në përgjithësi, përbën faktorin themelor, që diferencon këngën tonë të kaçakëve në mënyrë të qartë nga zhanri i balladave dhe i këngëve legjendare.

Përmbajtja realiste dhe lidhja e saj e ngushtë me formën artistike i jep këngës sonë një ndërtim më konciz e sintetik. Duke u shmangur narracioni epik, përsëritjet, figurat standard etj. shtjellimi i ngjarjeve bëhet i gjallë dhe me një ritëm të vrullshëm.

Dëgjuesi gjen tek secila këngë e këtij cikli një faqe të re nga historia e lavdishme e shpirtit luftarak dhe e përpjekjeve për liri të masave tona popullore.

Kjo gjerësi repertori nuk ka gjë të përbashkët me përpunimin dhe modelimin e varianteve që karakterizon këngët legjendare. Ndërsa në këto të fundit, nga karakteri i përgjithshëm i subjektit dhe i figurës së heronjve, mundësitë e improvizimit janë të gjera, te këngët tona të kaçakëve këto mundësi kufizohen nga sfondi i tyre historik. Heronjtë e këngëve tona të kaçakëve janë, sikurse u përmend edhe më lart, personazhe historike dhe jo personazhe të krijuara nga aktivizime figurash heronjsh të mëparshëm, ose nga një koncentrim i mëvonshëm artistik, siç ndodh p.sh. me Starina Novakun, Gruicën etj. të sllavëve të Jugut.

Të lindura në gjirin e masave popullore si një pasqyrim i drejtpërdrejtë i ngjarjeve luftarake, këngët tona të kaçakëve janë kënduar vazhdimisht nga këta si një shprehje e gjallë e traditës së tyre luftarake klasore. Pikërisht për arsye të lindjes dhe të lavrimit në gjirin e masave, ato kanë mbetur të pastra në përgjithësi nga ndikime të ideologjisë së klasave sunduese dhe nga elemente mistiko-fetare që vihen re në ndonjë balladë të tillë të ndonjë populli tjetër ballkanik.

Po nga këto arsye kënga jonë e kaçakëve nuk përmban edhe ato prirje etiko-moralizuese që rrjedhin nga tematika dhe përmbajtja ideore e këngëve me karakter legjendar.

Në rrethanat e lartpërmendura janë gdhendur në traditën e këngës sonë veçori të qenësishme strukturalo-stilistike si kristalizimi i formave tipike të hyrjes, specifika e figurave poetike, vija e shtjellimit të aksionit, e paraqitjes së gjesteve dhe e portretit fiziko-moral të heronjve etj.

Frymëzimi dhe ngritja e këngëve nën jehonën e drejtpërdrejtë të ngjarjeve të jetuara, bashkëveprimi edhe i faktorëve të tjerë të specifikës së vetë fenomenit folklorik, bëri që të fiksohen që në hyrje elemente reale nga ambjenti gjeografik e kohor, paraqitja e heronjve a e gjendjes së tyre shpirtërore, e rrethanave konkrete të nisjes së luftimeve etj. (krs. hyrjet: «Gjashtëdhjetë di seneja, / ç'u vra Andruc Murgaç luleja», «Në male mbi samarinë», «Njatje poshtë te mullini», «U vu topi n'at zabel» «Kush e theu burgun e parë», «Krisi pushka, mur gjamë deti, / thonë se n'Trush u ba kjameti», «Nga Korça vjen fermani, / lipset Shahin Kapedani, / Shahinin e mban Opari», «Po thërret telalli: kuja është kjo kamë». Ky Kodrazi në një brek, / shtatë dit' e shtatë net, / digjet zjarr, kërcet dyfek» etj.).

Në funksion dhe shprehje të këtyre faktorëve janë edhe të gjitha elementet e tjera që japin në mënyrë të gjallë koloritin e faktit historik. Le të përmendim më në fund se edhe simbolika e këngëve tona të kaçakëve është realiste. Heroi i një kënge kosovare p.sh., Shaqir Grizhta, në çastin e fillimit të ndeshjes me forcat armike, bisedon me armën e tij, duke e vënë në sedër atë për ta nxjerrë fitimtar:

A e sheh, hutë, se u rrethove?
 A e sheh hutë, se të kanë rrethue,
 ty me t'marrë, mue me m'damtue?
 N'at tebojë, ty kanë me t'çue,
 kanë me t'çue ty n'at tebojë,
 mos me t'marrë ma Shaqiri n'dorë,
 ka me t'marrë ty noj manof,
 qet me ty, po vret ka'j sorrë,
 thotë kam ba tash gajret boll...¹⁹

Me një kujdes të veçantë paraqiten në këngët shqiptare ndeshjet luftarake me armikun. Për të nxjerrë më mirë në pah përpjestimet e luftës, epërsinë morale të heronjve popullorë ndaj kundërshtarit etj. jepen shqetësimet e administratës shtetërore të pushtuesit, gjerësia e forcave që mobilizohen për ndjekjen e kaçakëve, bashkëpunimi me klasën feudale, egërsia në ndjekjen e tyre, kurthet, tradhëtitë etj. Përballë tyre vihen gjestet heroike të kaçakëve, aftësitë luftarake dhe vetitë e tyre të larta morale, që shpalosen në çastet dramatike të aksionit. Kaçakun e karakterizon në këto çaste gjakftohtësia, guximi, trimëria, besimi në fitoren, shpirti i vetmohimit, vendosmëria për ta çuar luftën deri në fund. Urrejtja ndaj armikut e bën të hidhet kundër tij me ndjenjën e një hakmarrjeje të vërtetë klasore. Në përshkrimin e këtyre detajeve këngët shprehin qartë dashurinë e thellë të masave popullore për heronjtë, solidarizimin me luftën e tyre të drejtë:

Në male, mbi Samarinë,
 dyfeqet radhë po binë,
 lufton Shemua me Hysninë!
 Prim-o Hysni Pasha, primë,
 të shoç Shemo mjekërzinë!²⁰

Njatje posht-o te mullini,
 luftë po bante Rexhep trimi,
 për gojet na i delte timi.
 O Rexhep i lokes-e,
 namë m'ja lae Gjakovës-e.
 O Rexhep i çikës-e,
 porsì yll i dritës-e!
 Njatje posht-o në Gyrçarë,
 luftë po ban me pashallarë...²¹

19) *Këngë popullore historike*, Tiranë 1956, f. 201.
 20-22) *Po aty, radhazi*, f. 177,190-191, 202.

Në mënyrë të veçantë ndjehet ky solidaritet tek përshkrimi i humbjeve të rënda që i shkaktohen armikut. Këto jepen shpeshherë me figura poetike dhe me sarkazëm të fuqishëm popullor, që demaskon plotësisht egërsinë dhe dobësinë e pushtuesit:

Fmija e shehrit dalin përpara:
— Lum na t'lumt, more Osman Aga,
ku i ke marrë kto kerr me dardha?
Nuk janë dardha, more fmi,
po kta janë zaptitë e mi,
t'tanë Shaqiri m'i ka gri
ja ço'pashës me i shti turshi²².

Me dashuri paraqitet sidomos në këngët e kaçakëve qëndrimi burror i heronjve në çastet e fundit të jetës. Bilbilentjët, që kishin tronditur administratën turke të gjithë Rumelisë, me litar në fyt, në çastin e ekzekutimit, duan akoma të polemizojnë me armikun për epërsinë e tyre morale.

Ngreu Bilbil e hidh litarë!
Dale bej, të pi cigarë,
se s'jam çanaku me dhallë,
po jam Bilbili me pallë!²³

Kapedan Naumi, kur i mbarohen fishekët dhe nuk sheh asnjë rrugëdalje, hidhet si shpend nga shkëmbenjtë:

T'u sosnë fishekët, mbete në vezmetë
ç'u pshtolle me gunë, u flake si shpesh,
more tatëpjetën, u hodhe n'lëndinë
Kapedan Naumi, rrëfeve trimërinë.²⁴

Salë Kondua, edhe pse me duar lidhur, zbraz pushkën me gishtin e këmbës dhe vret kumandarin e koshadhës duke shfryrë edhe në këto caste të fundit të jetës urrejtjen dhe hakmarrjen e tij kundër armikut:

As teslim nuk bëhem, as zihem i gjallë,
foli kumandarit, t'i them nja dy fjalë.
Me gjishtin e këmbës ma zbraze dogranë,
i re kumandarit, e prite në ballë.

Në tërësinë e aspekteve të ndërtimit të këngës sonë të kaçakëve ka elementë si p.sh. vija e përgjithshme e paraqitjes së zhvillimit të luftimeve, e përmbajtjes morale të figurës së heronjve, e solidaritetit të masave popullore me luftën e tyre etj., që janë veçori karakteristike edhe të këngës kleftike të popujve të Evropës juglindore në përgjithësi. Këto ngjajshmëri që i përkasin sferës tipologjike, sjellin ngjyrat e tyre kombëtare me fenomenet e konkretizimit të tyre në rrethanat historike dhe specifiken e veçantë folkloristike të çdo populli.

Në kuadrin e veçorive kombëtare janë për t'u përmendur edhe veçoritë e formës poetike të këngëve. Këngët shqiptare ndërtohen rregullisht

me vargun tetërrokësh, të theksuar në rrokjen e tretë dhe të shtatë (3:7). Në krahinat tona veriore në raste sporadike, nga ndikimi i rapsodive të kreshnikëve haset edhe dhjetërrokshi; ndërsa në Jugë, sidomos në zonat juglindore, këto këngë ndërtohen me vargje dymbëdhjetërrokësh me skemat 5:11 (gjashtërrokësh të dyzuar). Vargjet janë të rimuara, në përgjithësi me asonancë dhe në ndërtim monokolone, gjë që i jep mundësi më të gjera zhvillimit të frymëzimit poetik.

Nga veçoritë karakteristike të përmendura më lart si në drejtim të përmbajtjes ashtu edhe në atë të formës artistike shihet se varianti tip i këngës shqiptare të kaçakëve, krahas elementeve tipologjike të përbashkëta, dallohet në kuadrin e balladave kleftike të popujve të Evropës juglindore nga vijat e qarta realiste me të cilat paraqitet në përmbajtjen e saj realiteti historik, dhe nga elemente të formës artistike, që e veçojnë plotësisht atë nga gjinia tradicionale e këngës tregimtare, e cila është ruajtur në një mënyrë më pak ose më shumë të theksuar akoma për temën e kaçakëve në disa popuj të kësaj treve.

Kënga jonë e kaçakëve përfshihet kështu në gjininë e epikës sonë popullore historike. Megjithkëtë, edhe brenda këtij kuadri, ajo ruan fizionominë e vet. Në dallim nga kënga historike e mirëfilltë, ku zotëron kryesisht përqëndrimi i elementit epik, në këngën tonë të kaçakëve zotëron ai epiko-lirik, që përbën një veçori dalluese në strukturën e saj stilistike.

Lëvizja e kaçakëve me këngët e saj popullore meriton vëmendje si për rëndësinë historike, si një formë e protestës politiko-sociale, e luftës klasore, në kuadrin e përpjekjeve të popujve të Evropës juglindore për çlirimin e tyre kombëtar dhe ekonomiko-shoqëror, ashtu edhe për vlerën kulturele e artistike të krijimeve poetike, që lindën si jehonë e saj në letërsinë popullore. Krahas interesit të veçorive kombëtare, ajo formon një nyjë të rëndësishme në kulturën popullore të popujve të kësaj treve, që u farkëtua në rrethana të njëjta historiko-sociale, në kushtet e marrëdhënjeve shekullore midis tyre.

R é s u m é

APERÇU SUR LE MOUVEMENT ET LES CHANTS POPULAIRES DES KAÇAKS EN ALBANIE

Le mouvement des *kaçaks* a représenté une forme générale de la protestation contre la répression de la domination étrangère et contre le pressurage économique et social des classes au pouvoir. Les matériaux albanais apportent des attestations riches sur le caractère de classe de ce mouvement ainsi que sur les créations poétiques populaires qui ont pris naissance à la suite.

Les chants populaires des Albanais d'Italie, obligés à abandonner leur pays surtout après les guerres sanglantes anti-turques des XVe et XVIe siècles, évoquent des figures de combattants qui vivent au maquis après la destruction de la résistance armée albanaise de cette période.

D'autres chants aussi, remontant à des époques postérieures, montrent que le mouvement des *kaçaks* a été alimenté continuellement par des combattants qui n'ont jamais accepté la reddition après l'échec des grandes insurrections populaires.

D'autres figures de *kaçaks* sont obligées de prendre le chemin du maquis à cause

de l'injustice sociale du temps, de l'opposition aux lois financières, à la conscription militaire, à cause de leurs querelles contre les feudataires pour des raisons économiques et sociales (contre l'arbitraire de l'extension de leurs domaines, contre la soumission morale, etc.).

Dans la plupart des cas, les *kaçaks* sont originaires des couches sociales pauvres.

De l'intérêt offrent les éléments sur l'organisation des détachements des *kaçaks*, de leur discipline intérieure, de leur mode de vie et de leur activité guerrière, de l'autorité du chef ou du capitaine du détachement, etc.

Aux temps de l'anarchie de l'administration de l'envahisseur, les détachements des *kaçaks* se chargeaient de la garde d'une village particulier, d'une région particulière, laquelle de sa part leur subvenait en nourriture ou bien accourait aussi à leur aide et se battait par les armes en cas d'encerclement ou d'engagements avec les forces gouvernementales.

La tradition populaire conserve des souvenirs sur la solidarité des *kaçaks* avec les souffrances des indigents, sur les initiatives qu'ils prenaient à leur venir en aide ou bien à mettre leur travail au profit public.

L'activité des *kaçaks* albanais fait état d'instants de collaboration avec des *kaçaks* valaques, grecs et macédoniens. C'est dans les conditions d'une telle tradition de collaboration qu'ont pris naissance des influences réciproques soit pour ce qui est de l'activité guerrière, les formes organisationnelles, etc., que comme créations et emprunts artistiques populaires mutuels.

Rattachés à des événements et à des figures historiques fixées, les chants albanais des *kaçaks* reflètent le contenu fondamental des faits, moulé dans la pensée poétique. C'est précisément de ces chants qu'on y entrevoit gravée une langue artistique particulière, plus réelle, plus originale et plus nationale que celle des ballades à sujets d'un caractère international.

Nos chants des *kaçaks* sont caractérisés en tout premier lieu par l'absence de l'élément féérique. N'y sont pas ordinaires les formes traditionnelles de la composition épique, on n'y rencontre point ces lignes schématiques des introductions, du commencement et du développement de l'action, les répétitions, les dialogues, les figures, etc., qui sont en unité de la pensée poétique et de la forme artistique du chant légendaire.

L'absence de ces éléments, et surtout de l'élément féérique en général, constitue le facteur fondamental, qui différencie notre chant des *kaçaks* du genre des ballades ou des chants narratifs légendaires. Son contenu réaliste et son lien étroit avec la forme artistique donne à notre chant une construction plus concise et synthétique. C'est dans ces circonstances qu'ont été gravées dans la tradition de notre chant des particularités essentielles structurelles et stylistiques, comme la cristallisation de certaines formes typiques de l'introduction (formée à l'aide d'éléments réels empruntés au milieu géographique et temporel du développement des événements); le caractère de la symbolique des figures poétiques; le coloris réaliste du canevas de l'action, de la présentation des gestes et du portrait physico-moral des protagonistes, etc.

Notre chant des *kaçaks* est inséré ainsi dans le genre de notre épique historique. Tout de même, aussi à l'intérieur de ce cadre, il garde sa propre physionomie. A différence du chant historique proprement dit, où prédomine surtout l'élément épique, dans notre chant des *kaçaks* prédomine celui épico-lyrique, qui constitue une particularité distinctive dans sa structure stylistique.